



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 13.11.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 12.11.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Green Energy Kosova" për aktivitetin: "Organizimi i punetorive lidhur me informimin e aktereve me interes për kriteret e efijences se energjise ne ndertesa" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-7664-236 nxjerr:

V E N D I M

1. Pranohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Green Energy Kosova" e datës 12.11.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Organizimi i punetorive lidhur me informimin e aktereve me interes për kriteret e efijences se energjise ne ndertesa" me Nr.616 19 7664 236 kundër Njoftimit *për Vendimin e AK-se per dhënje të kontratës* te AK -së, të datës 08.11.2019, te publikuar ne web-faqe te KRPP-së.
2. Anulohet Vendimi për dhënje të kontratës i publikuar me datë: 08.11.2018;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te aktivitetin ta kthej ne rivlerësim*.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Green Energy Kosova" me datë 12.11.2019 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Organizimi i punetorive lidhur me informimin e aktereve me interes për kriteret e efijences se energjise ne ndertesa" me numër të prokurimit 616 19 7664 236.

Autoriteti Kontraktues, me datë 13.11.2018, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon lidhur me pretendimet për tenderuesin e propozuar për dhenje te kontrates:

Pretendimi se jane plotesuar kushtet per te kerkuar sqarime per çmim jo normalisht te ulet nga tenderuesi i propozuar për dhenje te kontrates eshte i bazuar, pasi qe eshte

konstatauar se jane plotesuar te tri kushtet per trajtimin e çmimit te tenderuesit te propozuar per dhenje te kontrates si tender jo normalisht i ulet dhe komisioni paraprak nuk ka vepruar ne harmoni me Rregullat per tenderet jonormalisht te ulet.

Bazuar në konstatimin paraprake konkludoj se aktiviteti duhet te kthehet ne rivleresim dhe anetaret e komisionit te rivleresimit duhet te ekzaminojne me kujdes dhe ne harmoni me dispozitat ligjore te gjitha tenderet e dorezuar, ndersa tenderin me çmimin me te ulet duhet ta trajtojne si tender me çmim jonormalisht te ulet dhe te kerkohen sqarimet lidhur me kete.

Zyrtarja e prokurimit qe administron kete lende duhet te kerkoj propozimet e reja per anetar te komisionit per rivleresim.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit